



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izhorni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.974/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Kymete Kicaj kryesuese, Ferki Xhaferi dhe Adnan Konushevci anëtar, duke vendosur përkritazi me apelin e kandidatit për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Fushë Kosovës Arlind Imeri nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës, me seli në Prishtinë, dega në Fushë Kosovës paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur më datë 07.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet i pabazuar apeli Anr.974/2021 i datës 04.11.2021, paraqitur nga kandidati për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Fushë Kosovës Arlind Imeri nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës, me seli në Prishtinë, dega në Fushë Kosovë, më të cilën ka kërkuar rinumërimin e votave në vendvotimet 0902E/01R, 0902E/02R, 0902E/03R, 0902E/04D, 0901E/02R, 0912E/01R, 0906E/01D, 0903E/02R, 0903E/03D, në Fushë Kosovë.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar apelin Anr.974/2021 me datën 04.11.2021 nga kandidati për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Fushë Kosovës Arlind Imeri nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës, me seli në Prishtinë, dega në Fushë Kosovë, më të cilën pretendon se në vendvotimet 0902E/01R, 0902E/02R, 0902E/03R, 0902E/04D, 0901E/02R, 0912E/01R, 0906E/01D, 0903E/02R, 0903E/03D, ka mos përputhje të rezultatit, në Formularin e Rezultateve të Kandidatëve rezultojnë më shumë vota se sa në Formularin E Rezultateve të Kandidatëve.

Si dëshmi ka bashkangjitur Formularët e Rezultateve të Kandidateve dhe Formularët e Përputhjes së të Dhënave.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, vlerësimit të pretendimeve ankimore, dhe në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pa bazuar

Nga shkresat e lëndës, rezulton se kandidati për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Fushë Kosovës Arlind Imeri nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës, me seli në

Prishtinë, dega në Fushë Kosovë, ka paraqitur apel më të cilën ka kërkuar rinumërimin e votave në vendvotimet e cekura më lartë.

Paneli, vlerësoi se parashtruesi i apelit në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi te qarta dhe bindëse lidhur me shkeljet e supozuara për mospërputhje të rezultateve, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret paneli, nuk mundi të konstatoj se ka pasur manipulime gjatë numërimit të votave për kandidat të këtij subjekti politik, ashtu siç pretendon ankuesi, për faktin se thëniet e tij nuk mbështetën në asnjë provë konkrete por janë supozime sepse pritjet e ankuesit për të marrë më shumë vota automatikisht nuk nënkupton se ka mospërputhje të rezultatit si dhe llogaritja matematikore nga ana e ankuesit nuk argumenton shkeljet e pretenduara në apel pasi që, subjekti politik mund të marrë vota më shumë se sa kandidatet për arsye se një votues mund ta votoj vetëm subjektin por jo edhe kandidatin.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr.974/2021 më datën 07.11.2021



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimin të këtij vendimi.